**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr., 685/ 14 prot. Datë 14 .05.2025

# V E N D I M

**Nr. 669 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 14.05.2025 shqyrtoi ankesën me,

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Sinteza Co" sh.p.k, dhe "Atom" sh.p.k në procedurën e prokurimit "E hapur " me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: "Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.". me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A).

**Ankimues:** Operatori ekonomik "PC Store" sh.p.k, me NIPT L01606034A *dhe adresë: Rruga "e Dibrës"*

**Autoriteti Kontraktor:** Albcontrol SH.A ( ish A.N.T.A*), me adresë: Aeroporti "Nënë Tereza", Rinas.*

**Subjekte të Interesuara:** "Sinteza Co" Sh.p.k, me NIPT: K11324003F, *me adresë: Rruga e Barrikadave, Qendra "Turdiu", kati III/2, Tiranë, 1057.*

"Atom" sh.p.k, me NIPT L22203042N *me adresë: Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga Islam Alla, Pallati Nr.56, Kati i 1.*

| | |
|---|---|
| **Baza Ligjore:** | Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*",i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*". |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.12.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur" me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt "Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.", me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa TVSH**),** zhvilluar më datë 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A).

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 26.02.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | |
|---|---|---|
| "Sinteza Co" sh.p.k | 12,534,500 lekë | Kualifikuar |
| "Atom" sh.p.k | 13.105.180 lekë | Kualifikuar |
| "Pc Store" sh.p.k | 13,212,400 lekë | Kualifikuar |
| "XPERT SYSTEMS"sh.p.k | 13,894,000 lekë | Skualifikuar |
| "BNT ELECTRONICS"sh.p.k | nuk ka të dhëna | |
| "NAOL" sh.p.k | nuk ka të dhëna | |

II.4. Në datën 03.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 10.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/5120 dhe me nr. protokolli 685/2025, protokolluar me datë 11.03.2025, e operatorit ekonomik "Pc Store" sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë "Sinteza Co" sh.p.k, "Atom" sh.p.k në procedurën e sipër përmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.994/2 prot, datë 25.04.2024, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë "Sinteza Co" sh.p.k, "Atom" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik "Sinteza Co" sh.p.k ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publiki ndryshuar , argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.685/2 prot., datë 17.03.2025 dhe kundërshtime të ankesës nr.685/1, protokolluar me tonën me nr. 685/3 datë 18.03.2025.

II.8.Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr. 878 prot., datë 28 .03.2025, protokolluar me tonën me nr. 685/5 prot., datë 0 1 .04.2025, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën objekt - anikimi, vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "PC Store " sh.p.k ku rezulton, se KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Gjithashtu

rezulton se vendimi i KSHA është i depozituar në sistemin elektronik, vendim i cili është protokolluar me nr. 686/6 datë 02.04.2025.

II.9. Me anë të shkresës datë 03.04.2025, protokolluar me tonën me nr.685/7 prot., dhe nr. 880/1 datë 02.04.2025, autoriteti kontraktor, ka përcjellë kthim përgjigje të shkresës së dërguar nga KPP, shkresë e cila mban nr.685/4prot., datë 26.03.2025 si dhe gjithashtu ka bashkëlidhur vendimin e KSHA-së.

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresave me nr. 685 /8 prot., datë 11.04.2025, si dhe shkresës me nr. 685/9prot., datë 11.04.2025, i është drejtuar operatorëve ekonomik "Sinteza Co" sh.p.k si dhe "Atom" sh.p.k, me lëndë "Kërkesë për informacion" lidhur kjo e fundit me evidentimin (markimin) e specifikimeve teknike.

II.11.Me shkresat protokolluar me tonën 685/10 prot., datë 14.04.2025 operatori ekonomik "Sinteza CO" sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresës së përmendur në pikën II.10 të këtij vendimi si dhe gjithashtu operatori ekonomik "Atom" shpk ka përcjellë shkresën protokolluar me tonën me nr.685/11prot., datë 16.04.2025, lidhur edhe kjo e fundit me kërkesën e sipërcituar në pikën II.10 të këtij vendimi.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

**Arsyeton**

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "PC Store " SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Atom " SHPK, me arsyen se: 1. *Së pari, AK "Albcontrol" sha, gjatë shqyrtimit të ofertave të paraqitura në SPE, duhet të kishte vlerësuar me vëmendje ofertën e ATOM, pasi kemi dyshimin e arsyeshëm që dokumentat shoqëruese të ofertës nuk janë në përputhje me ndryshimet e akteve nënligjore në fushën e prokurimit publik.*

*Konkretisht, referuar ndryshimeve në këtë formular, janë parashikuar shtim të seksioneve të vetëdeklarimit të gjendjes juridiko faktike, si vijon:*

*Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

*Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

***B: DEKLARATA***

***Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura***

*Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se: Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të* ndryshuar.

*Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër3 . Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:*

*e) çmimet; f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*

*h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë. Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta* të *produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj. ndryshime të cilat OE ATOM nuk i ka reflektuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

*Nisur faktet dhe informacionet e përjavshme të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike, kemi dyshimin e arsyeshëm që OE ATOM nuk ka paraqitur formularin e saktë të vetëdeklarimit sipas parashikimit nënligjor konkret, prandaj KVO duhet ta kishte skualifikuar.",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 9 "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit"*, në dokumentet standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 9**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari ______________ në cilësinë e ________________ të operatorit ekonomik _____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ----------------------------------------------- |

| | |
|---|---|
| Numri NIPT/et: | ---------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------ |
| Përfaqësuesi (emri): | --------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | ----------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**
**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**
**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|

| |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_________________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>______________________________________________<br>______________________________________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*____________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*___________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_____________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*____________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. |

| |
|---|
| Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_______________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____________________________________________________ |

**B: DEKLARATA**
**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

| |
|---|
| Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:<br><br>1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;<br><br>2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;<br><br>3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;<br><br>4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;<br><br>5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: |

a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ☐
   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). ☐

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

**C: DEKLARATA**
**Mbi Konfliktin e Interesit**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: |

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.
Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).
Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit**.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA**
**Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: |
| • Operatori ekonomik ________________________ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. |

| |
|---|
| • Operatori ekonomik____________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik _________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>_______________________________________________________ |

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**
**A: DEKLARATË**
**Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË**
**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | Punonjës<br>Po [ ] Jo [ ]<br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br>___<br>Profili i punonjësve<br>___________________________________________<br>Makineri e mjete<br>Po [ ] Jo [ ]<br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:<br>___ |

**Emri, Mbiemri_________________**
**Firma ________________________**
**Vula__________________________**
**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve publike rezulton, se operatori ekonomik "ATOM " SHPK, në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka paraqitur:

- Shtojca 9 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit"

III.1.4. Në neni 77, pika 1 "*Kërkesat për kualifikim*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" parashikon shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.5 Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për sa i përket mosplotësimit saktë sipas ndryshimeve të akteve nënligjore në fushën e prokurimit konkretisht të Shtojcës 9, nga ana e operatorit ekonomik "Atom " shpk , KPP gjykon se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton, se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Atom " shpk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku si në vijim janë plotësuar rubrikat e pretenduara nga operatori ankimues:...

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ***Deklaroj që Atom Shpk nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Provohet nga Vërtetimi i Mospërjashtimit nga APP.***

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ***Deklaroj që Atom Shpk i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.***

**B: DEKLARATA**
**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se**:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër[1].

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

a) çmimet;
b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Atom " shpk , është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*ATOM*" shpk me arsyen se: *[...] II. Së dyti, kemi dyshimin e arsyeshëm që OE ATOM nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.3 të Kapacitetit teknik në lidhje me autorizimin e prodhuesi/distributorit të autorizuar. Konkretisht AK Albcontrol ka kërkuar, sipas pikës 2.3.3 paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për "TERRITORIN SHQIPTAR", për produktet: • Laser Color Printer A3 • Laptop Tipi I • Laptop Tipi II • Laptop per menaxher• Ëorkstation Tipi 1. • Ëorkstation Tipi 2. • DESKTOP PC…[...],* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*", pika 2.3.3 "*Kapaciteti Teknik*", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, për shitjen/rishitjen për paisjet e ofertuara në këtë objekt prokurimi për territorin e Republikës së Shqiperisë. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

III.2.2. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit nr.162/2022 *"Për Prokurimin Publik"* parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.3. Neni 3 "*Parime të përgjithshme*" i ligjit nr. 162/2022 *"Për Prokurimin Publik"* parashikon se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.2.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
***4.** Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
***5.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje

me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.6. Nga verifikimet në SPE rezulton, se operatori ekonomik "ATOM SHPK" , në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka paraqitur:

- Shtojcën 8 pika 2.3.3 "*Kapaciteti Teknik*", të dokumenteve të procedurës së prokurimit operatori ekonomik "ATOM" SHPK rezulton se ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin me të dhëna si në vijim: Datë *Tiranë, më 04.02.2025, Nr. 78 Prot. Drejtuar: ALBCONTROL Lënda: Autorizim, ku në përmbajte rezulton se dokumentacioni është " autorizim" nga distributori i vënë ky i fundit në dizpozicion për operatorin ekonomik "ATOM" SHPK për procedurën me objekt prokurimi si më sipër përmendur*.

*[... Ky autorizim është i vlefshëm vetëm për produktet dhe markat e sipërcituara, të furnizuara kompanisë Atom shpk vetëm nëpërmjet kompanisë tonë.].*

*Gjithashtu operatori ekonomik rezulton se ka ngarkuar dokumentacionin si në vijim me të dhenat :*

Marrëveshja e Distributorit Lenovo – Offshore

**Faqja e nënshkimeve**

Distributori dhe Lenovo bien dakord me termat e kësaj Marrëveshje Distributori Lenovo – Offshore ("Marrëveshja") përfshirë Aneksin A – Detaje të marrëdhënies, bashkëngjitur këtu dhe që përbëjnë pjesë të saj.

Në dëshmi të sa më sipër, Distributori dhe Lenovo e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar në fuqi që nga data e nënshkrimit nga përfaqësuesi i autorizuar i Lenovo.

| | |
|---|---|
| Rënë dakord nga: | Rënë dakord nga: |
| Emri i Shoqërisë së Distributorit | Emri i Shoqërisë Lenovo |
| Nga: ITD sh.p.k. | Nga: (nënshkrim) |

AMENDIM I MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT HP NR.YCLEZ ( KËTU E MË POSHTË MARRËVESHJA )

**Ndërmjet**

ITD sh.p.k., Gjerrgji Center, Tiranë, Shqipëri

Dhe

Hewlett Packard Europe BV, Amsterdam, Dega Meyrin, Europe, Operacionet Lindje e Mesme & Afrikë, Route du Nant D'Avril 150, CH-1217 Meyrin 2, Gjenevë, Zvicër

Për sa më sipër referuar dokumentacionit të ngarkuar nga operatori ekonomik rezulton se në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik "Atom" shpk, ka ngarkuar në SPE marrëveshjet midis prodhuesit dhe distributorit.
Komisioni i prokurimit publik vlerëson se referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe pas verifikimeve të tij rezulton se operatori ekonomik në përmbush kriterin e parashikuar në pikën 2.3.3 të dokumentave standarte të tenderit nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*ATOM*" shpk me arsyen se: *[...]*Së treti kemi dyshimin e arsyeshëm që OE ATOM shpk nuk përmbush kriterin sipas pikëss 2.3.5 të Kapacitetit teknik në lidhje me paraqitjen e katalogëve të noterizuar dhe përkthyer sipas legjislacionit përkatës. Risjellim në vëmendje se AK Albcontrol ka kërkuar shprehimisht: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalog (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar ne rast se katalogu nuk është në gjuhen e kerkuar ne dokumenta tenderi) për pajisjet si më poshtë; • Laser Color Printer A3 • Laptop Tipi I • Laptop Tipi II • Laptop per menaxher • ëorkstation Tipi 1. • ëorkstation Tipi 2. • DESKTOP PC ku në katalogët përkatës të jetë specifikuar pajisja që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjejmë pasqyrim për parametrat teknikë të saj (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike (shih specifikimet teknike)." 16 Katalogët e kërkuar duhet të paraqiten që në fazën e paraqitjes së ofertës në SPE dhe kemi dyshimin e arsyeshëm që nuk janë paraqitur në formën e duhur.

III.3.1. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit nr.162/2022 *"Për Prokurimin Publik"* parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.2. Neni 3 "*Parime të përgjithshme*" i ligjit nr. 162/2022 *"Për Prokurimin Publik"* parashikon se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.3.3. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*
*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,*

*duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
***4.** Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
***5.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

III.3.4. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, ***autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla***.

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin,*

*si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

***h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);***

*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëseështë rasti;*

*k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6**. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

III.3.5. Në nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" te Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve 15 të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në

proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, 7 mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. 7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për 16 operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi. c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. 9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 ka kërkuar shprehimisht që: "***Pika 2.3.5. tek Kapaciteti Teknik bëhet:***

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalog **(të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar ne rast se katalogu nuk është në gjuhen e kerkuar ne dokumenta tenderi)** për pajisjet si më poshtë;• Laser Color Printer A3• Laptop Tipi I• Laptop Tipi II•Laptop per menaxher• Ëorkstation Tipi 1.• Ëorkstation Tipi 2.• DESKTOP PC ku në katalogët përkatës të jetë specifikuar pajisja që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjejmë pasqyrim për parametrat teknikë të saj **(të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike** (shih specifikimet teknike).
Katalogu/et duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallit sipas specifikimet teknike, të kërkuara në DST, sipas përcaktimeve në shtojcën 6, duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit". Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "ATOM" SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin lidhur me katalogët për artikujt e përmendur në kriterin 2.3.5 ;• Laser Color Printer A3• Laptop Tipi I• Laptop Tipi II•Laptop per menaxher• Ëorkstation Tipi 1.• Ëorkstation Tipi 2.• DESKTOP PC
Nisur nga arsyeja e pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues për mospërmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.5 përsa i përket paraqitjes së katalogëve te përkthyer, Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ky operator rezulton se operatori ekonomik përveç katalogëve për secilin artikull të ofertuar ka paraqitur edhe përkthimet e specifikimeve teknike për secilin artikull të lartë përmendur si dhe gjithashtu nga verifikimi rezulton se këto katalogje janë të përkthyera (*përkthyesi i licensuar nga Ministria e Drejtësisë)* si dhe të noterizuara, ndaj kërkesa e auroritetit kontraktor me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik "ATOM" SHPK, përmbushet nga ana e këtij te fundit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se pretendimet ankimuesit nuk qëndrojn, përsa kohë ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor në DST. Sa më lart, dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik "ATOM " ShPK do të konsiderohet i rregullt, duke plotësuar kështu kriterin 2.3.5 të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*ATOM*" shpk me arsyen se: *[...]*IV. Së katërti, kemi dyshime të arsyeshme të bazuara në indicje konkrete nga kryqëzimi i informacioneve publike, që OE ATOM nuk plotëson specifikimet teknike për pajisjet e paraqitua në AK Albcontrol, si vijon:
1. Kemi dyshime qe modeli i ofertuar nga OE ATOM, nuk ploteson specifikimet teknike te zerit 14. LAPTOP Tipi I KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE "Chipset": Intel i7 Gen8 ose Ekuivalent "RAM": 16 GB, min. DDR5 5200MT/s "Graphics": Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 Bateria "Battery": Min. 4 Cell, 64 Ëh

2. Kemi dyshime qe modeli i ofertuar nga OE ATOM nuk ploteson specifikimet teknike te zerit 15. LAPTOP Tipi II KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE “Chipset”: Intel i7 Gen9 ose Ekuivalent “RAM”: 16 GB, min. DDR5 5200MT/s “Graphics”: Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 Ekrani “Display”: ≥15.6" FHD LED (1920 x 1080), ), 60 Hz, 400 nits, IR FHD Camera and Mic ëith ËLAN 17 Bateria “Battery”: Min. 4 Cell, 64 Ëh
3. Kemi dyshime qe modeli i ofertuar nga OE ATOM, nuk ploteson specifikimet teknike te zerit 16. LAPTOP PER MENAXHER KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net: ≥19000 Pikë “Chipset”: Intel ose Ekuivalent “RAM”: 32 GB, Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”: 1T “Graphics”: Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 Ekrani “Display”: 13.3” me touch panel Pesha 1.5 Bateria “Battery”: 83 ËHr
4. Kemi dyshime qe modeli i ofertuar nga OE ATOM, nuk ploteson specifikimet teknike te zerit 17. ËORKSTATION TIPI 1. KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Karta Grafike “Graphics”: Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (3) Porta (VGA/DVI/HDMI/mDP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation. “Media Device”: DVD+/-RË ëith Dual Layer DVD+R ëri. Capacity “Slots”: Minimum (3) PCI/PCI-E nga të cilat min. (1) PCI-E x16 Dhe kemi arsyen e forte se nuk ploteson : 18 Karta Grafike “Graphics”: Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (3) Porta (VGA/DVI/HDMI/mDP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation. “Slots”: Minimum (3) PCI/PCI-E nga të cilat min. (1) PCI-E x16
5. Kemi dyshime qe modeli i ofertuar nga OE ATOM, nuk ploteson specifikimet teknike te zerit 18. ËORKSTATION TIPI 2. KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Karta Grafike “Graphics”: Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 20 GB Memory; Min. (4) Porta (VGA/DVI/HDMI/mDP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation. “Media Device”: DVD+/-RË ëith Dual Layer DVD+R ëri. Capacity “Slots”: Minimum (8) PCI/PCI-E nga të cilat min. (4) PCI-E x16 Rrjeti “Netëorking”: (3) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port, Min 1 porte 10Gb Dhe kemi arsyen e forte se nuk ploteson : Karta Grafike “Graphics”: Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 20 GB Memory; Min. (4) Porta (VGA/DVI/HDMI/mDP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation. “Slots”: Minimum (8) PCI/PCI-E nga të cilat min. (4) PCI-E x16 Rrjeti “Netëorking”: (3) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port, Min 1 porte 10Gb
Për sa më sipër, OE ATOM duhet të skualifikohet sepse nuk përmbush specifikimet teknike të mësipërme.

III.4. 1. Autoritteti kontraktor në shtojcën 6 të dokumentave standarte ka parashikuar kriteret si më poshtë:

**SPECIFIKIME TEKNIKE**

1. **Flat LED TV.**

| **KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE** | |
|---|---|
| **Teknologjia** | LED TV |
| **Rezolucioni** | ≥4K |

| | |
|---|---|
| **Madhesia e ekranit** | ≥55 inch |
| **Lidhja** | Netëork/Ëireless |
| **Portat** | HDMI, USB 2.0 |
| **Garancia** | Minimumi 2 Vite. |

2. **MFP COLOR A3.**

| **Karakteristika Minimale Teknike** | |
|---|---|
| **"Model":** | Printer |
| **Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4 B&Ë":** | ≥40 ppm |
| **Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":** | ≥150 000 Faqe |
| **Teknologjia "Technology":** | Laser Color/B&Ë |
| **Sirtarët për Letrën "Paper Trays":** | ≥1 |
| **Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min":** | ≥650 Fletë |
| **Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min Standard ":** | ≥250 Fletë |
| **Maksimumi I Rezolucionit të Printimit:** | 1,200 dpi x 1,200 dpi |
| **Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":** | Po |
| **Formati Maksimal i Letrës "Media Sizes":** | ≥A3 |
| **Memorja Standarte "Standard Memory":** | ≥1.5 GB |
| **"Toner":** | Shoqëruar me Starter Kit |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Porta e Komunikimit "Interface":** | High Speed USB 2.0 |
| **"Ethernet":** | Po |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll "Poëer Cord":** | Po, European |
| **Softëare/Drivers CD :** | Po |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Ëarranty":** | 2 Vjet ose 50 000 Kopje* |
| | ***Cila të arrihet më parë** |
| **Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.** | |

3. **Media Converter.**

| **Karakteristikat minimale teknike.** | |
|---|---|
| **Teknologjia** | Fiber Ethernet Media Converter |
| **Portat** | 10/100/1000 Base T/TX ne 1000Base FX Bridging Converter |
| **Distanca** | Min. deri ne 20km |
| **Nderfaqja** | UPC / Single Fiber / Single Mode / SC |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit. |

4. **Sëitch**

| **Specifikimet e Pajisjes** | |
|---|---|
| **Portat** | 8x 10/100/1000 Mbps RJ45 Ports AUTO Negotiation/AUTO MDI/MDIX |
| **Protokollet** | IEEE 802.3i, IEEE 802.3u, IEEE 802.3ab, IEEE 802.3x, IEEE 802.1q, IEEE 802.1p |

| | |
|---|---|
| **Transmetimi ne rrjet** | 10BASE-T: UTP category 3, 4, 5 cable (maximum 100m)<br>EIA/TIA-568 100Ω STP (maximum 100m)<br>100BASE-TX: UTP category 5, 5e cable (maximum 100m)<br>EIA/TIA-568 100Ω STP (maximum 100m)<br>1000BASE-T: UTP category 5, 5e, 6 or above cable (maximum 100m)<br>EIA/TIA-568 100Ω STP (maximum 100m) |
| **LED Indicator** | System Poëer<br>Link/Act indicators per port built into each RJ-45 port |
| **Tensioni ne dalje** | 5VDC / 0.6A |
| **Temperatura e Operimit** | 0°C~40°C |
| **Certifikimet** | CE, FCC, RoHS |
| **Garancia nga prodhuesi** | Minimumi 2 Vite |

5. **PC MONITOR.**

| **MONITORI** | |
|---|---|
| **Tipi "Type":** | LCD OSE LED |
| **Madhësia "Size":** | ≥ 27" |
| **Rezolucioni "Native Resolution":** | Full HD |
| **Raporti i Kontratit "Constrast Ratio Static":** | 1000:1 |
| **"Display Port":** | (1) DP dhe të paktën (1) HDMI |
| **Koha e Rifreskimit "Response Time":** | ≤ 1 ms |
| **Ushqimi "Poëer Supply":** | 220 V AC, 50 Hz |
| **Accessories:** | Poëer cable, HDMI cable, DP cable, USB cable |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Ëarranty":** | Minimumi 2 Vite |

6. **Karte per kontroll sinjali Ekran LED.**

| **Karakteristikat minimale teknike.** | |
|---|---|
| **Teknologjia** | Karte per kontrollin e sinjalit LED me ngjyra RGB. TS802D LED Sender Card ose ekuivalente. |
| **Rezolucioni** | 1280x1024 – 2048x640 pixels ose me mire |
| **Portat** | DVI;2xUPT RJ45 |
| **Garancia** | Minimumi 1 Vit |

7. **Adapter.**

| **Karakteristikat minimale teknike.** | |
|---|---|
| **Teknologjia** | Adaptor/Konvertues |
| **Porta hyrese** | HDMI |

| | |
|---|---|
| **Porta dalese** | RS232 |
| **Garancia** | Minimumi 1 Vit. |

8. **Adapter.**

| **Karakteristikat minimale teknike.** | |
|---|---|
| **Teknologjia** | Adaptor/Konvertues |
| **Porta hyrese** | HDMI |
| **Porta dalese** | DisplayPort |
| **Garancia** | Minimumi 1 Vit. |

9. **Headset me USB.**

| **KUFJE** | |
|---|---|
| **Modeli:** | Headset |
| **Veçoritë:** | Të jetë fleksibël për të ndryshuar përmasat (zmadhim, zvogëlim).<br>Mikrofoni të ofrojë reduktimin e zhurmave. |
| **Tipi i lidhjes me kompjuterin:** | USB Tipi A |
| **Butonat:** | Butonat e volumit +/-<br>Butoni "Mute"<br>Butoni per pegjigjen e telefonatave |
| **Përshtatshmëria:** | Ëindoës, Mac. |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Ëarranty":** | Minimumi 2 Vite |

10. **Ëeb Kamera.**

| **KAMERA ËEB** | |
|---|---|
| **Modeli:** | Ëebcam,  Min. Full HD 1080P |
| **Autofocus:** | Jo i detyrueshëm |
| **Mikrofon i integruar:** | Po |
| **Ndërfaqja me kompjuterin:** | USB tipi A |
| **Field of vieë:** | Min. 85° |
| **Mënyra e instalimit:** | Automatikisht (pa pasur nevoje për drivera) |
| **Sistemi i Operimit te suportuar:** | Ëindoës 10 64-bit Prof. dhe me i mire, Mac, etj. |
| **Mënyra e vendosjes:** | Mbi ekran |
| **Gjatësia e kabullit:** | Min. 1.5 m |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Ëarranty":** | Minimumi 1 Vit. |

11. **SSD.**

| **SSD** | |
|---|---|
| **Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size"** | ≥1000 Tera |
| **Shpejtësia e Hard Diskut "SSD Speed":** | SATA (6Gb/s) |
| **Permasat:** | 2.5" |
| **Terabajt e shkruar,"TBË"deri ne** | 36TB |

| | |
|---|---|
| **“Sequential Read/Ërite”** | 540/500 MB/s |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | <u>Minimumi 2 Vite</u> |

12. **<u>Hdd te Jashtme 512 GB.</u>**

| **HDD TE JASHTME** | |
|---|---|
| **Modeli:** | SSD, e jashtme (portable) |
| **Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:** | =512 GB |
| **Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:** | Deri ne 1050 MBps |
| **Veçoritë:** | Enkriptim 256-bit AES<br>Rezistent ndaj ujit<br>Rezistent ndaj pluhurit |
| **Ndërfaqja me kompjuterin:** | USB 3.2 Gen 2 |
| **Sistemi i Operimit te suportuar:** | Apple MacOS X 10.6 ose me i mire, Ëindoës 8, Ëindoës 8.1, Ëindoës 10 |
| **Standard:** | IEC 60529 IP55 |
| **Temperatura e operimit:** | 0°C- 45°C |
| **Temperatura e magazhinimit:** | -20°C to 85°C |
| **Rezistent ndaj shokut:** | Deri ne 1500G |
| **Rezistent ndaj vibrimeve:** | 5 gRMS, 10-2000Hz |
| **Certifikatat:** | CE, FCC, RCM, BSMI, EAC, UKCA, ICES, BIS |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë nga prodhuesi “Ëarranty”:** | <u>Minimumi 2 Vite.</u> |

13. **<u>Hdd te Jashtme 2 TB.</u>**

| **HDD TE JASHTME** | |
|---|---|
| **Modeli:** | SSD, e jashtme (portable) |
| **Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:** | =2000 GB |
| **Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:** | Deri ne 1050 MBps |
| **Veçoritë:** | Enkriptim 256-bit AES<br>Rezistent ndaj ujit<br>Rezistent ndaj pluhurit |
| **Ndërfaqja me kompjuterin:** | USB 3.2 Gen 2 |
| **Sistemi i Operimit te suportuar:** | Apple MacOS X 10.6 ose me i mire, Ëindoës 8, Ëindoës 8.1, Ëindoës 10 |
| **Standard:** | IEC 60529 IP55 |
| **Temperatura e operimit:** | 0°C- 45°C |
| **Temperatura e magazhinimit:** | -20°C to 85°C |
| **Rezistent ndaj shokut:** | Deri ne 1500G |
| **Rezistent ndaj vibrimeve:** | 5 gRMS, 10-2000Hz |
| **Certifikatat:** | CE, FCC, RCM, BSMI, EAC, UKCA, ICES, BIS |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë nga prodhuesi “Ëarranty”:** | <u>Minimumi 2 Vite.</u> |

**14. LAPTOP Tipi I**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:** | ≥14500 Pikë |
| **"Chipset":** | Intel i7 Gen8 ose Ekuivalent |
| **"RAM":** | 16 GB, min. DDR5 5200MT/s |
| **Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":** | ≥ 256 GB SSD M.2 NVMe |
| **"Graphics":** | Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 |
| **Ekrani "Display":** | ≥15.6" FHD LED (1920 x 1080), ), 60 Hz, 400 nits, IR FHD Camera and Mic ëith ËLAN |
| **Bateria "Battery":** | Min. 4 Cell, 64 Ëh |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit "Ports":** | Min. (4) porta USB nga të cilat min.<br>(2)USB Type-C USB 3.1<br>(2)USB Type-A USB 3.1<br>(1) DP/HDMI<br>(1) Integrated Mic.<br>(1) Integrated HD Ëeb Camera<br>(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack |
| **Rrjeti "Netëorking":** | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);<br>Ëireless 802.11ac/ax (Kompatibël me 802.11b/g/n/ax);<br>Bluetooth min. V4.1; |
| **"Sound":** | Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) |
| **Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":** | OEM Ëindoës 11 Pro 64 |
| **Tastiera "Keyboard":** | QËERTY, Single Pointing Backlit |
| **"Pointing Device":** | Touch Pad |
| **Siguria "Security":** | Trusted Platform Module TPM 2.0 |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll "Poëer Cord":** | Po, European |
| **Ushqyesi "Recharger":** | Po |
| **Çanta "Carrying Bag":** | Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë. |
| **"Recover":** | Recover Partition |
| **GARANCIA** | |

| | |
|---|---|
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | Minimumi 3 Vite |

15. **LAPTOP Tipi II**

| **KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE** | |
|---|---|
| **Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:** | ≥14500 Pikë |
| **“Chipset”:** | Intel i7 Gen9 ose Ekuivalent |
| **“RAM”:** | 16 GB, min. DDR5 5200MT/s |
| **Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:** | ≥ 512 GB SSD M.2 NVMe |
| **“Graphics”:** | Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 |
| **Ekrani “Display”:** | ≥15.6" FHD LED (1920 x 1080), ), 60 Hz, 400 nits, IR FHD Camera and Mic ëith ËLAN |
| **Bateria “Battery”:** | Min. 4 Cell, 64 Ëh |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit “Ports”:** | Min. (4) porta USB nga të cilat min.<br>(2)USB Type-C USB 3.1<br>(2)USB Type-A USB 3.1<br>(1) DP/HDMI<br>(1) Integrated Mic.<br>(1) Integrated HD Ëeb Camera<br>(1/1) Headphone/Microphone Jack ose<br>(1) Combo Jack |
| **Rrjeti “Netëorking”:** | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);<br>Ëireless 802.11ac/ax (Kompatibël me 802.11b/g/n/ax);<br>Bluetooth min. V4.1; |
| **“Sound”:** | Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) |
| **Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:** | OEM Ëindoës 11 Pro 64 |
| **Tastiera “Keyboard”:** | QËERTY, Single Pointing Backlit |
| **“Pointing Device”:** | Touch Pad |
| **Çanta “Carrying Bag”:** | Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë. |
| **“Recover”:** | Recover Partition |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | Minimumi 3 Vite |

**15 LAPTOP Tipi II**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:** | ≥14500 Pikë |
| **“Chipset”:** | Intel i7 Gen9 ose Ekuivalent |
| **“RAM”:** | 16 GB, min. DDR5 5200MT/s |
| **Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:** | ≥ 512 GB SSD M.2 NVMe |
| **“Graphics”:** | Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 |
| **Ekrani “Display”:** | ≥15.6" FHD LED (1920 x 1080), ), 60 Hz, 400 nits, IR FHD Camera and Mic ëith ËLAN |
| **Bateria “Battery”:** | Min. 4 Cell, 64 Ëh |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit “Ports”:** | Min. (4) porta USB nga të cilat min.<br>(2)USB Type-C USB 3.1<br>(2)USB Type-A USB 3.1<br>(1) DP/HDMI<br>(1) Integrated Mic.<br>(1) Integrated HD Ëeb Camera<br>(1/1) Headphone/Microphone Jack ose<br>(1) Combo Jack |
| **Rrjeti “Netëorking”:** | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);<br>Ëireless 802.11ac/ax (Kompatibël me 802.11b/g/n/ax);<br>Bluetooth min. V4.1; |
| **“Sound”:** | Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) |
| **Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:** | OEM Ëindoës 11 Pro 64 |
| **Tastiera “Keyboard”:** | QËERTY, Single Pointing Backlit |
| **“Pointing Device”:** | Touch Pad |
| **Siguria “Security”:** | Trusted Platform Module TPM 2.0 |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll “Poëer Cord”:** | Po, European |
| **Ushqyesi “Recharger”:** | Po |
| **Çanta “Carrying Bag”:** | Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë. |
| **“Recover”:** | Recover Partition |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | Minimumi 3 Vite |

**16 LAPTOP PER MENAXHER**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:** | ≥19000 Pikë |
| **“Chipset”:** | Intel ose Ekuivalent |
| **“RAM”:** | 32 GB, |
| **Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:** | 1T |
| **Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:** | OEM Ëindoës 11 Pro 64 |
| **“Graphics”:** | Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 |
| **Ekrani “Display”:** | 13.3” me touch panel |
| **Pesha** | <1.5 kg |
| **Bateria “Battery”:** | 83 ËHr |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | Minimumi 3 Vite |

**17 ËORKSTATION TIPI 1.**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:** | ≥14500 Pikë |
| **“RAM”:** | ≥32 GB, min. DDR5-4400 MT/s |
| **Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:** | (1) x 512 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD |
| **Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:** | ≥7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD |
| **“Disk Subsystem Controler”:** | Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface ëith RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1) |
| **Karta Grafike “Graphics”:** | Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 4 GB Memory; Min. (3) Porta (VGA/DVI/HDMI/mDP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation. |
| **“Media Device”:** | DVD+/-RË ëith Dual Layer DVD+R ëri. Capacity |
| **“Slots”:** | Minimum (3) PCI/PCI-E nga të cilat min. (1) PCI-E x16 |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |

| | |
|---|---|
| **Portat e Komunikimit “Ports”:** | Min. (10) USB nga të cilat:<br>a. Min. (4) USB Para; b. Min. (8) USB 3.2<br>(2) RJ-45, (1) Audio In/Out,<br>(1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor) |
| **Rrjeti “Netëorking”:** | (2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port |
| **“Sound”:** | Integrated Sound Card |
| **Siguria “Security Management”:** | Embedded Security TPM 2.0 |
| **Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:** | OEM Ëindoës 11 64-bit Professional për Ëorkstation |
| **Tastiera “Keyboard”:** | Standart Keyboard QËERTY |
| **“Mouse”:** | Minimum 3 Button Scroll Optical |
| **Ushqimi “Poëer Supply”:** | 220 V AC, 50 Hz |
| **Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:** | Energy Star |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll “Poëer Cord”:** | Po, European |
| **“Recover”:** | Recover Partition |
| **MONITORI** | |
| **Tipi “Type”:** | LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin |
| **Madhësia “Size”:** | ≥ 23" |
| **Rezolucioni “Native Resolution”:** | 1920 x 1080 @ 60 Hz |
| **Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”:** | 1000:1 |
| **Koha e Rifreskimit “Response Time”:** | ≤ 6 ms |
| **“Display Port”:** | (1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI |
| **Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:** | Energy Star |
| **Ushqimi “Poëer Supply”:** | 220 V AC, 50 Hz |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | **Minimumi 3 Vite** |

## 18 ËORKSTATION TIPI 2.

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:** | ≥46,000 Pikë, Intel Xeon ose ekuivalent |
| **“RAM”:** | ≥128 GB, min. DDR4-2933 MT/s |
| **Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:** | (1) x 1 TB SSD Class 40 Sistemi Operativ |
| **Karta Grafike “Graphics”:** | Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 20 GB Memory; Min. (4) Porta (VGA/DVI/HDMI/mDP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për ëorkstation. |

| | |
|---|---|
| **“Media Device”:** | DVD+/-RË ëith Dual Layer DVD+R ëri. Capacity |
| **“Slots”:** | Minimum (8) PCI/PCI-E nga të cilat min. (4) PCI-E x16 |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit “Ports”:** | Min. (10) USB nga të cilat:<br>a. Min. (4) USB Para; b. Min. (8) USB 3.1<br>(3) RJ-45, min. 1 porte 10Gb (1) Audio In/Out,<br>(1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor) |
| **Rrjeti “Netëorking”:** | (3) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port, Min 1 porte 10Gb |
| **“Sound”:** | Integrated Sound Card |
| **“Speakers”:** | Internal speakers or Built-in Monitor |
| **Siguria “Security Management”:** | Embedded Security TPM 2.0 |
| **Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:** | OEM Ëindoës 11 64-bit Professional për Ëorkstation |
| **Tastiera “Keyboard”:** | Standart Keyboard QËERTY |
| **“Mouse”:** | Minimum 3 Button Scroll Optical |
| **Ushqimi “Poëer Supply”:** | 220 V AC, 50 Hz |
| **Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:** | Energy Star |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll “Poëer Cord”:** | Po, European |
| **“Recover”:** | Recover Partition |
| **MONITORI** | |
| **Tipi “Type”:** | LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin |
| **Madhësia “Size”:** | ≥ 23" |
| **Rezolucioni “Native Resolution”:** | 1920 x 1080 @ 60 Hz |
| **Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”:** | 1000:1 |
| **Koha e Rifreskimit “Response Time”:** | ≤ 6 ms |
| **“Display Port”:** | (1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI |
| **Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:** | Energy Star |
| **Ushqimi “Poëer Supply”:** | 220 V AC, 50 Hz |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | **Minimumi 3 Vite** |

III.7.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; 8 ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat

e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.” Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.7.3. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose 9 shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e

tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.7.4 Në nenin 40 pika 6, “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citohet: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike

III.7.5 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Pc Store” shpk, për skualifikimin e ofertës së “Sinteza CO” SHPK në procedurën e prokurimit objekt prokurimi, konkretisht për **zërin 14 dhe 15 Laptop 1** “Chipset”: Intel i7 Gen8 ose Ekuivalent “RAM”: 16 GB, min. DDR5 5200MT/s “Graphics”: Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 Bateria “Battery”: Min. 4 Cell, 64 Ëh dhe **Laptop 2** “Chipset”: Intel i7 Gen9 ose Ekuivalent “RAM”: 16 GB, min. DDR5 5200MT/s 11 “Graphics”: Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 Ekrani “Display”: ≥15.6" FHD LED (1920 x 1080), ), 60 Hz, 400 nits, IR FHD Camera and Mic ëith ËLAN Bateria “Battery”: Min. 4 Cell, 64 ëh, Komisioni pas verifikimeve të dokumentacionit të administruar nëpërmjet rrugeve të sistemit elektronik konstaton se në lidhje me pajisjet objekt prokurimi, cituar në si më lart në shtojcën 6, Komisioni i prokurimit

gjykon se Operatori ekonomik, referuar parametrave të pajisjes së katalogut, ka përmbushur specifikimet teknike me oferten e tij për zërat : 14 dhe 15 , kërkuar në specifikimet teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sinteza CO ” shpk , kreu verifikimet mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, me specifikimet teknike të pajisjeve së ofertuara nga operatori ekonomik “Sinteza CO ” shpk dhe konstatoi, se specifikimet teknike të katalogut të dorëzuar janë në përputhje me specifikimet të cilat parashikohen shprehimisht nga autoriteti kontraktor në shtojcën përkatëse të tenderit, për procedurën objekt shqyrtimi. Për sa arsyetuar më sipër Komisoni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike për artikujt me nr. **zërin 14 dhe 15 Laptop 1** dhe **Laptop 2** të shtojcës 6.

Per sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për ofertuesin “Sinteza CO” SHPK për mospërmbushjen e specifikimeve teknike për zërin me nr. rendor 16 “Laptop Menaxher":

**16 LAPTOP PER MENAXHER**

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:** | ≥19000 Pikë |
| **“Chipset”:** | Intel ose Ekuivalent |
| **“RAM”:** | 32 GB, |
| **Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:** | 1T |
| **Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:** | OEM ëindoës 11 Pro 64 |
| **“Graphics”:** | Dedicated Graphics ëith min. 4 GB Memory GDDR6 |
| **Ekrani “Display”:** | 13.3” me touch panel |
| **Pesha** | <1.5 kg |
| **Bateria “Battery”:** | 83 WHr |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:** | Minimumi 3 Vite |

III.8.1 Komisioni thekson se është barrë e operatorit ekonomik ofertues në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se me pajisjet e ofertuara, në rastin konkret me paraqitjen e katalogëve përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik nëpërmjet shkresës e cila mban datën 14.04.2025 me objekt “Dërgim informacioni ” protokolluar me tonën 685/10, datë 14.04.2025 ku i është e kërkuar

nga Komisioni nëpërmjet shkresës 685/8 datë 11.04.2025 evidentimi dhe markimi i specifikimeve teknike në katalogjet e kërkuar në DST, nga operatori ekonomik, Komisioni pasi kreu verifikimet mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, me specifikimet teknike të pajisjes së ofertuar nga operatori ekonomik "Sinteza CO" konstatoi, se specifikimet teknike të katalogut të dorëzuar nuk janë në përputhje me specifikimet të cilat parashikohen shprehimisht nga autoriteti kontraktor në shtojcën përkatëse të tenderit, për procedurën objekt shqyrtimi konkretisht lidhur me specifikimin teknik për artikullin me nr. rendor 16 Laptop Menaxher "**Bateria "Battery": 83 WHr**" nga ku rezulton se bateria e evidentuar në katalog është 70 ëhr, e cila rezulton jo në përputhje me specifikimin e parashikuar nga autoriteti kontraktor për ofertuesit për tu plotësuar për realizimin objektit prokurimit për nevojat institucionale.
Sa me lart rezulton se nga verifikimet e katalogut të operatorit ekonomik "Sinteza CO" SHPK nuk përmbush kriterin e percaktuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit konkretisht shtojca 6, artikulli **nr. rendor 16 "Laptop Menaxher".**

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron .

III.9. Lidhur me pretendimet e tjera operatorit ekonomik ankimues "Pc Store" SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Sinteza CO" SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për operatorin ekonomik "Sinteza CO" SHPK qëndrojnë, lidhur me pikën III. 8 të këtij vendimi, për sa kohë operatori ekonomik "Sinteza CO" SHPK nuk përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në shtojcën 6, të dokumentave standarte të tenderit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP- së, do të mbetet i skualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me pikat tjera të pretendimeve nuk do të merren në shqyrtim për efekt të Parimit Ekonomisë Administrative .

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

**Vendos:**

1.Të pranojë pjesërisht  ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit  “E hapur ” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.". me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A).
2.Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorët ekonomik “Atom” shpk dhe  “ Sinteza CO” SHPK.
3.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4.Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK.
3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| **Nënkryetar** | **Anëtar** | **Anëtar** | **Anëtar** |
|---|---|---|---|
| **Fiorent Zguro** | **Anila Malaj** | **Gjergj Mersini** | **Kreshnik Ternova** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

**MENDIM KUNDËR**

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anëtar) në lidhje me vendimin e shumicës.
Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Pc Store" SHPK, konkretisht nuk jam dakord lidhur me arsyetimin e shumicës si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

| | |
|---|---|
| **Objekt**: | Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Sinteza Co" sh.p.k, dhe "Atom" sh.p.k në procedurën e prokurimit "E hapur " me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: "Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.". me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A). |

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyetoj**

**I. Mungesa e një baze të strukturuar në ankesë.**

Bazuar nga verifikimin e ofertave të operatorve ekonomik në këtë procedurë prokurimi, gjykoj se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen e kritereve kualifikuese nga "ATOM" SHPK dhe "Sinteza" SHPK, operatori ekonomik ankimues "PC Store ka bëre ankesë në total pasi ka kundërshtuar të gjithe kriteret dhe pretendon që të gjitha këto elemente nuk plotesohet nga operatorët ekonomik "ATOM" SHPK dhe "Sinteza" SHPK.
Më tej, është e rëndësishme të nënvizohet se, **sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik dhe parimeve të së drejtës procedurale**, barra e provës për të vërtetuar ekzistencën e një shkeljeje apo të një mosrespektimi të dispozitave ligjore në vendimmarrjen e autoritetit kontraktor, **bie mbi operatorin ekonomik ankimues**. Kjo nënkupton se për të mbështetur vlefshmërinë e pretendimit të tij, BOE ankimues ka për detyrë:

1- Të identifikojë me qartësi **çështjen ligjore apo faktike që kundërshton**.
2- Të saktësojë **bazën ligjore apo dokumentare** mbi të cilën mbështet pretendimin.

3- Të paraqesë **prova, indicie dhe/ose argumente logjike** që krijojnë bindjen se vendimmarrja e autoritetit kontraktor është e pajustifikuar apo e gabuar.

Në mungesë të një argumentimi të tillë të plotë dhe të strukturuar, **shqyrtimi i ankimit nuk mund të bëhet mbi supozime**, por vetëm mbi elementë objektivë, të provuar dhe të identifikueshëm nga vetë operatori ekonomik.

Në rastin konkret, ankimuesi **nuk ka arritur të evidentojë me saktësi faktin apo rrethanën ku mbështet pretendimin e tij për përmbushje të kritereve**, as nuk ka paraqitur **ndonjë element të ri provues**, i cili të përgënjeshtrojë arsyetimin e autoritetit kontraktor mbi kulifikimin e operatorve ekonomik "ATOM" SHPK dhe "Sinteza" SHPK . Thjesht kundërshtimi formal në total i vendimit të KVO, **pa një analizë faktike dhe ligjore të dokumentacionit të dorëzuar dhe të akteve të autoritetit**, nuk përmbush standardin e duhur të një ankimi të argumentuar dhe të mbështetur në ligj.

Bazuar në parimin e **efikasitetit të procedurës së ankimit**, si dhe në funksionin kontrollues të kufizuar të Komisionit në verifikimin e akteve të autoritetit kontraktor në dritën e të dhënave të paraqitura nga palët, **mungesa e një baze të qartë, të strukturuar dhe të provuar të pretendimit** nga ana operatori ekonomik ankimues "PC Store bën që ankimi të jetë nje ankese në total duke u konsideruar thjesht një kundërshtim i natyrës "in abstracto", dhe jo një kërkesë e ndërtuar mbi parimin e rregullsisë procedurale dhe mbrojtjes së interesit legjitim
dhe si pasojë ankesa e operatorit ekonomik ankimues "PC Store **<u>nuk qëndron</u>**.

**II. Rëndësia e qasjes proporcionale dhe efektive në vlerësimin teknik.**

Në vijim të analizës, në lidhje me pretendimet për mospërputhje me specifikimet teknike për produktin "laptop", evidentohet se të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë formuluar me diapazon, përmes përdorimit të shenjave krahasuese (≥, ≤) apo përmes termit "ose ekuivalent".

Kjo qasje përputhet me **nenin 41 të Ligjit nr. 162/2020**, që ndalon në mënyrë të prerë përshkrimin e objektit të kontratës në mënyrë që kufizon konkurrencën ose favorizon një produkt specifik. Përdorimi i diapazoneve është **praktikë e ligjshme dhe e shëndetshme**, që garanton konkurrencë të ndershme dhe mbështet vlerësimin mbi performancën e ofertës, dhe jo mbi markën apo burimin unik të furnizimit.

Megjithatë, pikërisht në këtë kuadër, bie në sy vendosja e **një kriteri teknik fiks dhe i panegociueshëm** – konkretisht kërkesa që bateria për laptop të jetë "**<u>83 Whr</u>**", pa tolerancë, pa diapazon, pa term ekuivalent. Kjo përbën një indicie të rrezikshëm nga parimi i konkurrencës dhe barazisë në tendera, sepse:

- **Kriteri fiks është i panevojshëm teknikisht**, pasi fuqia e baterisë për një laptop është funksion i një game produktesh të disponueshme në treg dhe zakonisht shoqërohet me variante ose diferenca të papërfillshme.

- **Kjo kërkesë e ngushton fushën e konkurrencës në mënyrë artificiale**, duke e përjashtuar çdo operator që ka ofertë me 56 Ëhr, 72 Whr ose 84 Whr, ndonëse ato mund të kenë performancë të barasvlefshme apo më të lartë.
- **Në analizën faktike rezulton se vetëm një operator ekonomik përmbush këtë specifikim në mënyrë të përpiktë**, çka krijon një indicie serioze të paracaktimit të fituesit ose të një mundësie bashkëpunimi të paligjshëm ndërmjet autoritetit kontraktor dhe një operatori të veçantë.

**III. Efekti juridik i kritereve teknike fiksuese – shkelje e barazisë në garë**

Në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", autoriteti kontraktor është i detyruar të garantojë trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë. **Vendosja e një kriteri të vetëm si "fiks" në mesin e të gjitha specifikimeve të tjera me tolerancë, krijon një pabarazi të padrejtë, që nuk justifikohet nga ndonjë nevojë teknike reale** dhe për këtë arsye bie ndesh me ligjin.

Praktika e Komisionit të Prokurimit Publik ka theksuar në mënyrë të përsëritur se:

"*Çdo specifikim teknik që paracakton një produkt ose përjashton mundësinë e ofertës së ekuivalenteve, përbën kufizim të konkurrencës dhe shkelje të barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë.*"

Në këtë rast, përdorimi i vetëm i një kriteri fiks për baterinë 83 Ëhr në një kontekst tërësisht të bazuar në vlera krahasuese, **krijon dyshime të forta për devijim nga objektiviteti**, duke hapur rrugë për bashkëpunim të dyshimtë ndërmjet autoritetit dhe një operatori të paracaktuar.

Ky akt bie ndesh me parimin e integritetit, të sanksionuar në  ligjin për prokurimin publik dhe mund të jetë subjekt hetimi administrativ apo penal në rast të dyshimeve të mjaftueshme.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", ***vendos:***

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Pc Store" SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit  "E hapur " me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: "Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.". me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A).

2. Autoriteti kontraktues të anuloj procedurën e prokurimit mbi shkeljen e konstatuar.

3. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për Autoritetin Kontraktor për konstatimet e mësipërme dhe shkeljet e kryera nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

**Anëtar**
**Kreshnik Ternova**

**MENDIM KUNDËR**

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik znj.Anila Malaj (Anëtar) në lidhje me vendimin e shumicës.
Si anëtare i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK.
Konkretisht nuk jam dakord lidhur me arsyetimin e shumicës si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me:

**Objekt**: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k, dhe “Atom” sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur ” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.". me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A).

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyetoj**

Bazuar nga verifikimin e ofertave të operatorve ekonomik në këtë procedurë prokurimi, gjykoj se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen e kritereve kualifikuese nga “ATOM” SHPK dhe “Sinteza” SHPK, operatori ekonomik ankimues “PC Store ka bëre ankesë në total pasi ka kundërshtuar të gjithe kriteret dhe pretendon që të gjitha këto elemente nuk plotesohen nga operatorët ekonomik “ATOM” SHPK dhe “Sinteza” SHPK. Per mendimin tim kjo ankese eshte ne total dhe nuk perben shkak per veprime te tjera sepse kjo ankese ka nje mungese dhe nuk eshte e strukturuar me te gjitha elementet e saj.

Më tej, është e rëndësishme të nënvizohet se, **sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik dhe parimeve të së drejtës procedurale**, barra e provës për të vërtetuar ekzistencën e një shkeljeje apo të një mosrespektimi të dispozitave ligjore në vendimmarrjen e autoritetit kontraktor, **bie mbi operatorin ekonomik ankimues**. Kjo nënkupton se për të mbështetur vlefshmërinë e pretendimit të tij, BOE ankimues ka për detyrë:

1- Të identifikojë me qartësi **çështjen ligjore apo faktike që kundërshton**.
2- Të saktësojë **bazën ligjore apo dokumentare** mbi të cilën mbështet pretendimin.

3- Të paraqesë **prova, indicie dhe/ose argumente logjike** që krijojnë bindjen se vendimmarrja e autoritetit kontraktor është e pajustifikuar apo e gabuar.

Në mungesë të një argumentimi të tillë të plotë dhe të strukturuar, **shqyrtimi i ankimit nuk mund të bëhet mbi supozime**, por vetëm mbi elementë objektivë, të provuar dhe të identifikueshëm nga vetë operatori ekonomik.

Në rastin konkret, ankimuesi **nuk ka arritur të evidentojë me saktësi faktin apo rrethanën ku mbështet pretendimin e tij për përmbushje të kritereve**, as nuk ka paraqitur **ndonjë element të ri provues**, i cili të përgënjeshtrojë arsyetimin e autoritetit kontraktor mbi kulifikimin e operatorve ekonomik "ATOM" SHPK dhe "Sinteza" SHPK . Thjesht kundërshtimi formal në total i vendimit të KVO, **pa një analizë faktike dhe ligjore të dokumentacionit të dorëzuar dhe të akteve të autoritetit**, nuk përmbush standardin e duhur të një ankimi të argumentuar dhe të mbështetur në ligj.

Bazuar në parimin e **efikasitetit të procedurës së ankimit**, si dhe në funksionin kontrollues të kufizuar të Komisionit në verifikimin e akteve të autoritetit kontraktor në dritën e të dhënave të paraqitura nga palët, **mungesa e një baze të qartë, të strukturuar dhe të provuar të pretendimit** nga ana operatori ekonomik ankimues "PC Store" bën që ankimi të jetë nje ankese në total duke u konsideruar thjesht një kundërshtim i natyrës "in abstracto", dhe jo një kërkesë e ndërtuar mbi parimin e rregullsisë procedurale dhe mbrojtjes së interesit legjitim
dhe si pasojë ankesa e operatorit ekonomik ankimues "PC Store **nuk qëndron**.

Lidhur me arsyetimin e mesiperm:

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Pc Store" SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit "E hapur " me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: "Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.". me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A ( ish A.N.T.A).

2. Autoriteti kontraktues të anuloj procedurën e prokurimit mbi shkeljen e konstatuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

**Anëtar**
**Anila Malaj**

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2025.05.20
05:10:38

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2025/05/20 17:10:16 +02'00'
98a55fdad9b4489ab559cb9156401da4202505201
7100784020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*